



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 27.03.2024

NR.09/2423 /2024

KONTRATË PËR FURNIZIM-SHËRBIM

Numri i kontratës ¹: 659-24-2658-2-4-7/C505 & KKHE(VM) 24-007-247

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

BK SH.P.K., Rr.Arberia p.n. Hani i Elezit, NUI.811167122 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me goma dhe shërbime të balancimit e montimi të gomave- sipas nevojës me numër identifikues: 659-24-2658-2-4-7

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me goma dhe shërbime të balancimit e montimi të gomave- sipas nevojës

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. *Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej nëntë (9) mujave nga dt. 27.03.2024-27.12.2024*

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë *tek OE- i lartcekura apo sipas lokacionit ku do të ketë nevojë të kryehet shërbimi i rregullimit të gomave në teren sipas rastit që ndodhë.*

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **953,00 €**; [Nëntqind e pesdhjetë e tre euro e zero zero cent]

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 është vlera e kontratës por se . Pagesa do të bëhet sipas-furnizimit shërbimi që do të realizohet i kërkuar dhe i pranuar nga AK.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: *N/A*

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Avdush BAJRAMALIU
Pozita:	Zyrtar i Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2024
Vula:	

Për Furnizuesin BK SH.P.K.,

Emri:	Basri KALISI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	27.03.2024
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-22-9036-1-4-7/C290

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë [Gjykata Themelore Ferizaj dega Kaçanik]
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	[N/A]
Sigurimi	10.1	[N/A]
Programi i ekzekutimit	11	[Kohë-gjatja e kontrates është me afat prej nëntë (9) mujave nga dt.27.03.2024-27.12.2024]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimi duhet të jete kualitativ dhe i pranuar nga AK- Per ecurin e kesaj kontrate do te kujdeset Drejtoria e Administrates se Pergjithshme-respektivisht udhëheqesi i njësëi se autoparkut z. Sadik Brava
Inspektimi dhe testimi	19.2	AK- Respektivisht Komuna Hani i Elezit do te kontrolloj cilesn dhe sasin e realizimit te furnizimit dhe sherbimit
Pagesa	20.1	Pagesa do te behet sipas-furnizimit sherbimi qe do te realizohet i pranuar nga AK. Pagesa do te behet brenda aftit ligjor
Dorëzimi	21.3	Dorezimi do te jete sipas kushteve te kesaj kontrate- i pranuar nga AK- ja,materiali te jete adekuat per riparim dhe rregullim te gomave sipas kekeses qe jane percaktuar ne ftesen per ofertim
Obligimet e garancionit	24.1	[Gomat qe do te furnizohen te kene garancion min.6 muaj nga koha e pranimit dhe montimit te tyre ne veturat e AK-së]
	24.5	
Shërbimet pas shitjes	25.1	[Gomat qe do te furnizohen te kene garancion min.6 muaj nga koha e pranimit dhe montimit te tyre ne veturat e AK-së]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose permes procedurave alternative te zgjidhje se mosmarrveshjeve-procedurat e ndermjetesimit me pajtimin e te dy palve
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Ferizaj dega Kaçanik] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].